Në bazë të nenit 36 paragrafi 1 pika 15 të Ligjit për vetëqeverisje lokale ("Gazeta Zyrtare e RM-së", nr. 5/02 dhe "Gazeta Zyrtare e RMV-së", nr.202/24) dhe nenit 21 paragrafi 1 pika 43 të Statutit të Komunës së Jegunovcit ("Fletorja Zyrtare e Komunës së Jegunovcit"nr. 21/03), Këshilli i Komunës së Jegunovcit në mbledhjen e pesëdhjetedy të mbajtur më 10.03.2025 mori:

VENDIM

për dhënien e pëlqimit Llogarisë vjetore për vitin 2024 të SHFK„Simçe Nastovski'' Vratnicë

Neni1

Këshilli i Komunës së Jegunovcit jap pëlqim Vendimit për pranimin e llogarisë vjetore për vitin 2024 të SHFK„Simçe Nastovski'' Vratnicë.

për llogarinë dotacione buxhetore në nivel lokal	731010733190315
për llogarinë e të hyrave vetanake	731010733178710
për llogarinë e dotacioneve komunale	731010733160316
për llogarinë e të hyrave buxhetore	160010733160310

të cilën Këshilli i shkollës së SHFK„Simçe Nastovski'' Vratnicë e pranoi më 20.02.2025 me nr. 05-54/1, nr. 05-54/2, nr. 05-54/3, nr. 05-54/4

Neni 2

Ky Vendim hyn në fuqi në ditën e shpalljes në "Fletorja Zyrtare e Komunës së Jegunovcit".

Nr. 08-527/10
10.03.2025
Jegunovc

KËSHILLI I KOMUNËS SË JEGUNOVCIT
Kryetari
Perica Saveski,d.v.

Në bazë të nenit 50 paragrafi 1 pika 3 lidhur me nenin 62 paragrafi 4 të Ligjit për vetëqeverisje lokale ("Gazeta zyrtare e RM-së" nr. 5/2002) dhe nenit 39 paragrafi 1 neni 54 lidhur me nenin 53 paragrafi 3 të Statutit të Komunës së Jegunovcit ("Fletorja zyrtare e Komunës së Jegunovcit" nr. 21/03), kryetari i Komunës së Jegunovcit ,mori:

A K T V E N D I M

për shpalljen e Vendimit për dhënien e pëlqimit Llogarisë përfundimtare të vitit 2024 të IPL-Biblioteka "Светлина"-"Drita" f. Prelubishtë-Komuna e Jegunovcit

Shpallet Vendimi për dhënien e pëlqimit Llogarisë përfundimtare të vitit 2024 të IPL-Biblioteka "Светлина"-"Drita" f. Prelubishtë-Komuna e Jegunovcit, që Këshilli i Komunës së Jegunovcit e miratoi në mbledhjen e mbajtur më 10.03.2025.

Nr. 09-580/9
11.03.2025
Jegunovc

KOMUNA E JEGUNOVCIT
Kryetari
Dimitar Kostadinoski,d.v.

Në bazë të nenit 36, paragrafi 1, pika 15 të Ligjit për vetëqeverisje lokale ("Gazeta Zyrtare e RM-së",nr. 5/02 dhe nenit 21 paragrafi 1 pika 43 të Statutit të Komunës së Jegunovcit (" Fletorja zyrtare e Komunës së Jegunovcit " nr. 21/03), Këshilli i Komunës së Jegunovcit në mbledhjen e pesëdhjetedy të mbajtur më 10.03.2025, mori

V E N D I M

për dhënien e pëlqimit Llogarisë përfundimtare të vitit 2024 të IPL-Biblioteka "Светлина"-"Drita" f. Prelubishtë-Komuna e Jegunovcit

Neni 1

Këshilli i Komunës së Jegunovcit jep pëlqim Vendimit për miratimin e Llogarisë përfundimtare të vitit 2024 të IPL-Biblioteka "Светлина"-"Drita" f. Prelubishtë-Komuna e Jegunovcit nr. 0202-7/3, që KD I IPLB e mori në mbledhjen e mbajtur më 11.02.2025.

Neni 2

Ky Vendim hyn në fuqi ditën e shpalljes në "Fletoren zyrtare të Komunës së Jegunovcit".

Nr. 08-527/11
10.03.2025
Jegunovc

KËSHILLI I KOMUNËS SË JEGUNOVCIT
Kryetari
Perica Saveski, d.v.

Në bazë të nenit 50 paragrafi 1 pika 3 lidhur me nenin 62 paragrafi 4 të Ligjit për vetëqeverisje lokale ("Gazeta zyrtare e RM-së" nr. 5/2002) dhe nenit 39 paragrafi 1 neni 54 lidhur me nenin 53 paragrafi 3 të Statutit të Komunës së Jegunovcit ("Fletorja zyrtare e Komunës së Jegunovcit" nr. 21/03), kryetari i Komunës së Jegunovcit ,mori:

AKTVENDIM

për shpalljen e Vendimit për dhënie pëlqim Llogarisë vjetore për vitin 2024 të Ndërmarrjes publike komunale për kryerjen e punëve botore JEGUNOVCI f. Jegunovc, Jegunovc

Shpallet Vendimi Për dhënie pëlqim Llogarisë vjetore për vitin 2024 të Ndërmarrjes publike komunale për kryerjen e punëve botore JEGUNOVCI f. Jegunovc, Jegunovc, që Këshilli i Komunës së Jegunovcit e miratoi në mbledhjen e mbajtur më 10.03.2025.

Nr. 09-580/10
11.03.2025
Jegunovc

KOMUNA E JEGUNOVCIT
Kryetari
Dimitar Kostadinoski,d.v.

Në bazë të nenit 36 paragrafi 1 pika 9 të Ligjit për vetëqeverisje lokale (‘’ Gazeta zyrtare e RM-së’’ nr. 5/02 dhe „Gazeta zyrtare e RMV-së’’ nr. 202/24) dhe nenit 21 paragrafi 1 pika 43 të Statutit të Komunës së Jegunovcit (‘’ Fletorja zyrtare e Komunës së Jegunovcit ‘’ nr. 21/03), Këshilli i Komunës së Jegunovcit në mbledhjen e pesëdhjetedy të mbajtur më 10.03.2025 ,mori

V E N D I M

Për dhënie pëlqim Llogarisë vjetore për vitin 2024 të Ndërmarrjes publike komunale për kryerjen e punëve botore JEGUNOVCI f. Jegunovc, Jegunovc

Neni 1

Me këtë Vendim Këshilli i Komunës së Jegunovcit jep pëlqim Vendimit për miratimin e Llogarisë vjetore për vitin 2024 të Ndërmarrjes publike komunale për kryerjen e punëve botore JEGUNOVCI f. Jegunovc, Jegunovc nr. 02-95/3 , të cilën Këshilli drejtues i Ndërmarrjes publike komunale për kryerjen e punëve botore JEGUNOVCI f. Jegunovc, Jegunovc e mori me datë 28.02.2025.

Neni 2

Ky Vendim hyn në fuqi në ditën e shpalljes në ‘’Fletoren zyrtare të Komunës së Jegunovcit’’.

Nr. 08-527/12
10.03.2025
Jegunovc

KËSHILLI I KOMUNËS SË JEGUNOVCIT
Kryetari
Perica Saveski,d.v.

Në bazë të nenit 50 paragrafi 1 pika 3 lidhur me nenin 62 paragrafi 4 të Ligjit për vetëqeverisje lokale ("Gazeta zyrtare e RM-së" nr. 5/2002) dhe nenit 39 paragrafi 1 neni 54 lidhur me nenin 53 paragrafi 3 të Statutit të Komunës së Jegunovcit ("Fletorja zyrtare e Komunës së Jegunovcit" nr. 21/03), kryetari i Komunës së Jegunovcit ,mori:

A K T V E N D I M

për shpalljen e Konkluzionit për miratimin e Raportit për realizimin e Programit për ndërtimin, rindërtimin dhe mirëmbajtjen e udhëve lokale dhe rrugëve në Komunën e Jegunovcit për vitin 2024

Shpallet Konkluzioni për miratimin e Raportit për realizimin e Programit për ndërtimin, rindërtimin dhe mirëmbajtjen e udhëve lokale dhe rrugëve në Komunën e Jegunovcit për vitin 2024, që Këshilli i Komunës së Jegunovcit e miratoi në mbledhjen e mbajtur më 10.03.2025.

Nr. 09-580/11
11.03.2025
Jegunovc

KOMUNA E JEGUNOVCIT
Kryetari
Dimitar Kostadinoski,d.v.

Në bazë të nenit 36 pika 15 të Ligjit për vetëqeverisjen lokale ("Gazeta zyrtare e RM-së" nr. 5/02) dhe të nenit 21 pika 43 të Statutit të Komunës së Jegunovcit ("Fl. zyrtare e Komunës së Jegunovcit" nr. 21/03), Këshilli i Komunës së Jegunovcit në mbledhjen e pesëdhjetedy mbajtur më 10.03.2025, mori

KONKLUZION
për miratimin e Raportit për realizimin e Programit për ndërtimin, rindërtimin dhe mirëmbajtjen e udhëve lokale dhe rrugëve në Komunën e Jegunovcit për vitin 2024

1. **Miratohet** Raporti për realizimin e Programit për ndërtimin, rindërtimin dhe mirëmbajtjen e udhëve lokale dhe rrugëve në Komunën e Jegunovcit për vitin 2024 , nr. 09-524/1 të dt. 04.03.2025 dhe i njëjti është pjesë përbërëse e këtij Konkluzioni.

2. Ky Konkluzion hyn në fuqi në ditën e shpalljes në "Fletoren zyrtare të Komunës së Jegunovcit".

Nr. 08-527/13
10.03.2025
Jegunovc

KËSHILLI I KOMUNËS SË JEGUNOVCIT
Kryetari
Perica Saveski,d.v.

Në bazë të nenit 50 paragrafi 1 pika 3 lidhur me nenin 62 paragrafi 4 të Ligjit për vetëqeverisje lokale ("Gazeta zyrtare e RM-së" nr. 5/2002) dhe nenit 39 paragrafi 1 neni 54 lidhur me nenin 53 paragrafi 3 të Statutit të Komunës së Jegunovcit ("Fletorja zyrtare e Komunës së Jegunovcit" nr. 21/03), kryetari i Komunës së Jegunovcit ,mori:

A K T V E N D I M

për shpalljen e Programit për ndërtimin,rindërtimin dhe mirëmbajtjen e rrjetit të udhëve lokale dhe rrugëve të Komunës së Jegunovcit për vitin 2025

Shpallet Programi për ndërtimin,rindërtimin dhe mirëmbajtjen e rrjetit të udhëve lokale dhe rrugëve të Komunës së Jegunovcit për vitin 2025, që Këshilli i Komunës së Jegunovcit e miratoi në mbledhjen e mbajtur më 10.03.2025.

Nr. 09-580/12
11.03.2025
Jegunovc

KOMUNA E JEGUNOVCIT
Kryetari
Dimitar Kostadinoski,d.v.

Në bazë të nenit 60 dhe 61 të Ligjit për udhët publike ("Gazeta zyrtare e RM-së", nr. 84/2008, 52/2009,114/2009,124/10, 23/11, 53/11....163/16) dhe nenit 36 paragrafi 1 pika 15 të Ligjit për vetëqeverisjen lokale ("Gazeta zyrtare e RM-së", nr. 5/02 dhe "Gazeta zyrtare e RMV-së", nr. 202/24) dhe nenit 21 paragrafi 1 pika 12 të Statutit të Komunës së Jegunovcit ("Fletorja zyrtare e Komunës së Jegunovcit",nr. 21/03) , Këshilli i Komunës së Jegunovcit në mbledhjen e pesëdhjetedy të mbajtur më 10.03.2025, miratoi

PROGRAM

për ndërtimin,rindërtimin dhe mirëmbajtjen e rrjetit të udhëve lokale dhe rrugëve të Komunës së Jegunovcit për vitin 2025

Me këtë Program insistohet që të përfshihen të gjitha punët vjetore për ndërtimin,rindërtimin dhe mirëmbajtjen e rrjetit të udhëve lokale dhe rrugëve në Komunën e Jegunovcit për vitin 2025.

Përveç kësaj në Program do të përfshihen edhe punët rreth aneks ndërtimit të linjave të ndriçimit publik dhe mirëmbajtjes së ndriçimit publik nëpër vendbanimet e komunës.

Realizimi i punëve të parapara me Programin në bazë do të varet nga derdhja e mjeteve financiare për vitin rrjedhës 2025 si edhe nga angazhimi i vetëqeverisjes vendore në ndërtimin dhe mirëmbajtjen e rrjetit të udhëve lokale dhe rrugëve.

Sipas Lajmërimit nga NP për udhë shtetërore–Shkup,mjetet e destinuara për ndërtimin, rindërtimin, mirëmbajtjen dhe mbrojtjen e udhëve lokale dhe rrugëve në Komunën e Jegunovcit për vitit 2025 do të jenë: 2.293.969,00 denarë.

I. Të hyrat	
1. Agjencia për udhë shtetërore	2.293.969 den.
2. Kompensimi për ndriçimin publik	8.000.000 den.
3. Kompensimi për tokën ndërtimore	800.000 den.
Gjithsej:	**11.093.969 den.**

Nga të hyrat e parapara mjetet do të realizohen siç vijon:

II. Të dalat	
1. Për ndërtimin e udhëve lokale dhe rrugëve	2.293.969 den.
2. Për energjinë elektrike të harxhuar	
- ndërtimi dhe mirëmbajtja e ndriçimit publik	8.000.000 den.
3. Për mirëmbajtje rrjedhëse investuese	800.000 den.
Gjithsej:	**11.093.969 den.**

Nga mjetet e planifikuara për ndërtimin dhe mirëmbajtje parashihen këto punë:

Ndërtimi i udhëve lokale dhe rrugëve,sanimi i pjesëve më të dëmtuara të rrjetit të udhëve lokale dhe tamponimi i rrugëve nëpër vendbanimet e Komunës së Jegunovcit.

Për mirëmbajtje dimërore të rrjetit të udhëve lokale do të angazhohet organizatë e pajisur me makineri për atë dedikim.

Mjetet e parapara nga Agjencia për udhë shtetërore sipas të dalave do të ishin:

- për ndërtim 50 % 1.146.984 den.
- për mirëmbajtje investuese të rregullt 50 % 1.146.985 den.

Mjetet e planifikuara për ndriçimin publik do të realizohen për energjinë elektrike të harxhuar,për blerjen e pajisjeve elektrike për ndriçimin publik dhe për mirëmbajtjen e ndriçimit publik.

Mjetet e planifikuara për kompensim për tokë ndërtimore do të realizohen për mirëmbajtje rrjedhëse investuese për udhë dhe rrugë.

Realizimi i Programit do të varet nga derdhja e mjeteve.

Ky Program hyn në fuqi ditën e shpalljes në "Fletoren zyrtare të Komunës së Jegunovcit".

Nr. 08-527/14
10.03.2025
Jegunovc

KËSHILLI I KOMUNËS SË JEGUNOVCIT
Kryetari
Perica Saveski,d.v.

Në bazë të nenit 50 paragrafi 1 pika 3 lidhur me nenin 62 paragrafi 4 të Ligjit për vetëqeverisje lokale ("Gazeta zyrtare e RM-së" nr. 5/2002) dhe nenit 39 paragrafi 1 neni 54 lidhur me nenin 53 paragrafi 3 të Statutit të Komunës së Jegunovcit ("Fletorja zyrtare e Komunës së Jegunovcit" nr. 21/03), kryetari i Komunës së Jegunovcit ,mori:

A K T V E N D I M

për shpalljen e Vendimit për zgjedhje të anëtarit të Këshillit drejtues të NPP „Rusino – Pollog"

Shpallet Vendimi për zgjedhje të anëtarit të Këshillit drejtues të NPP „Rusino – Pollog", që Këshilli i Komunës së Jegunovcit e miratoi në mbledhjen e mbajtur më 10.03.2025.

Nr. 09-580/13
11.03.2025
Jegunovc

KOMUNA E JEGUNOVCIT
Kryetari
Dimitar Kostadinoski,d.v.

Në bazë të nenit 17 dhe 17-g të Ligjit për ndërmarrjet publike ("Gazeta zyrtare e RM" nr. 38/96, 9/97, 6/02, 40/03, 49/06, 22/07, 83/09, 97/10, 6/12, 119/13, 41/14, 138/14, 25/15, 61/15, 39/16, 64/18, 35/19 dhe "Gazeta zyrtare e RMV-së" nr. 275/19 89/22 dhe 274/22), dhe nenit 7 paragrafi 1 dhe 2 të Rregullores për formën dhe përmbajtjen e thirrjes publike, mënyrën e parashtrimit të fletëparaqitjes, formularët për paraqitje, mënyra e vlerësimit dhe selektimit të kandidatëve dhe çështje të tjera lidhur me zbatimin e procedurës për emërim dhe shkarkim të anëtarëve të këshillit drejtues ë ndërmarrjeve publike ("Gazeta zyrtare e RMV-së" nr. 283 të datës 27.12.2022) nenit 36 paragrafi 5 të Ligjit për vetëqeverisje lokale ("Gazeta zyrtare e RM" nr. 5/02), me propozim të Komisionit për selektim për zgjedhje të anëtarit të Këshillit drejtues të NPP „Rusino- Pollog'' , Këshilli i Komunës së Jegunovcit në mbledhjen e pesëdhjetedytë të mbajtur më 10.03.2025, miratoi:

V E N D I M

për zgjedhje të anëtarit të Këshillit drejtues të NPP „Rusino – Pollog"

Neni 1

Me këtë Vendim, Këshilli i Komunës së Jegunovcit, emëron anëtar të Këshillit drejtues të NPP „Rusino- Pollog'', në bazë të komisionit të formuar paraprakisht për selektim për zgjedhje të anëtarit të Këshillit drejtues të NPP "Rusino - Pollog ''

Për anëtar të Këshillit drejtues të NPP "Rusino - Pollog'' emërohet:

-Zorica Cvetkovska Dimovski

Neni 2

Komisioni për selektim shpalli Thirje publike për paraqitjen e personave të interesuar për anëtar të Këshillit drejtues të NPP „Rusino – Pollog'', të cilin në emër të Këshillit të Komunës së Jegunovcit, e shpalli kryetari i Këshillit të Komunës së Jegunovcit.

Në Thirrjen publike u paraqit vetëm kandidati i lartshënuar, i cili pas shqyrtimit dhe vërtetimit të të gjithë dëshmive të bashkangjitura të cilat ishin të nevojshme për përzgjedhje të anëtarit të Këshillit drejtues nga ana e komisionit u përcaktua se i njëjti i plotëson të gjitha kushtet dhe i njëjti emërohet për anëtar të Këshillit drejtues të NPP "Rusino - Pollog''.

Neni 3

Ky Vendim hyn në fuqi në ditën e shpalljes në "Fletoren zyrtare të Komunës së Jegunovcit".

Nr. 08-527/15
10.03.2025
Jegunovc

KËSHILLI I KOMUNËS SË JEGUNOVCIT
Kryetari
Perica Saveski,d.v.

Në bazë të nenit 50 paragrafi 1 pika 3 lidhur me nenin 62 paragrafi 4 të Ligjit për vetëqeverisje lokale ("Gazeta zyrtare e RM-së" nr. 5/2002) dhe nenit 39 paragrafi 1 neni 54 lidhur me nenin 53 paragrafi 3 të Statutit të Komunës së Jegunovcit ("Fletorja zyrtare e Komunës së Jegunovcit" nr. 21/03), kryetari i Komunës së Jegunovcit ,mori:

A K T V E N D I M

për shpalljen e Vendimit për miratimin e Planit për menaxhim me rrezikun nga vërshimet në territorin e Komunës së Jegunovcit

Shpallet Vendimi për miratimin e Planit për menaxhim me rrezikun nga vërshimet në territorin e Komunës së Jegunovcit , që Këshilli i Komunës së Jegunovcit e miratoi në mbledhjen e mbajtur më 10.03.2025.

Nr. 09-580/14
11.03.2025
Jegunovc

KOMUNA E JEGUNOVCIT
Kryetari
Dimitar Kostadinoski,d.v.

Në bazë të nenit 67 të Ligjit për mbrojtje dhe shpëtim ("Gazeta zyrtare e RM-së" nr. 36/04, 49/04, 86/06, 124/10, dhe 18/11) nenit 122 pika 1 dhe nenit 123 pika 1 të Ligjit për ujrat ("Gazeta zyrtare e RMV-së" nr.87/2021), nenit 21 pika 1 dhe nenit 22 pika 10 të Ligjit për vetëqeverisje lokale ("Gazeta zyrtare e RM-së" nr. 5/02 dhe "Gazeta zyrtare e RMV-së" nr. 202/24) dhe neni15 pika 10 të Statutit të Komunës së Jegunovcit 9„Fletorja zyrtare e Komunës së Jegunovcit'' nr. 21/03), Këshilli i Komunës së Jegunovcit në mbledhjen e pesëdhjetedy të mbajtur më 10.03.2025, miratoi,

V E N D I M

për miratimin e Planit për menaxhim me rrezikun nga vërshimet në territorin e Komunës së Jegunovcit

Neni 1

Me këtë Vendim miratohet Plani për menaxhim me rrezikun nga vërshimet në territorin e Komunës së Jegunovcit.

Neni 2

Ky Vendim hyn në fuqi në ditën e shpalljes në "Fletoren zyrtare të Komunës së Jegunovcit".

Nr. 08-527/16
10.03.2025
Jegunovc

KËSHILLI I KOMUNËS SË JEGUNOVCIT
Kryetari
Perica Saveski,d.v .

Në bazë të nenit 50 paragrafi 1 pika 3 lidhur me nenin 62 paragrafi 4 të Ligjit për vetëqeverisje lokale ("Gazeta zyrtare e RM-së" nr. 5/2002) dhe nenit 39 paragrafi 1 neni 54 lidhur me nenin 53 paragrafi 3 të Statutit të Komunës së Jegunovcit ("Fletorja zyrtare e Komunës së Jegunovcit" nr. 21/03), kryetari i Komunës së Jegunovcit ,mori:

AKTVENDIM

për shpalljen e Vendimit për mënyrën e kryerjes së video mbikëqyrjes së hapësirave publike në territorin e Komunës së Jegunovcit

Shpallet Vendimi për mënyrën e kryerjes së video mbikëqyrjes së hapësirave publike në territorin e Komunës së Jegunovcit, që Këshilli i Komunës së Jegunovcit e miratoi në mbledhjen e mbajtur më 10.03.2025.

Nr. 09-580/15
11.03.2025
Jegunovc

KOMUNA E JEGUNOVCIT
Kryetari
Dimitar Kostadinoski,d.v.

Në bazë të nenit 36 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë, nr. 05/02), dhe në lidhje me nenin 90 të Ligjit për mbrojtjen e të dhënave personale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë, nr. 42/20 dhe 249/20, dhe neni 15 paragrafi 2 dhe 4 të Statutit të Komunës së Jegunovcit („Fletorja zyrtare e Komunës së Jegunovcit'' nr. 21/03, 16/10, 20/14, 26/15, 17/19 dhe 36/24), Këshilli i Komunës së Jegunovcit në mbledhjen e pesëdhjetedy të mbajtur më 10.03.2025, miratoi:

V E N D I M
PËR MËNYRËN E KRYERJES SË VIDEO MBIKQYRJES SË HAPËSIRAVE PUBLIKE NË TERRITORIN E KOMUNËS SË JEGUNOVCIT

Neni 1

Me këtë Vendim rregullohet mënyra e kryerjes së video mbikëqyrjes të hapësirave publike në territorin e Komunës së Jegunovcit (në tekstin e mëtejmë: Komuna), përkatësisht: kryerja e mbikëqyrjes së hapësirave publike në territorin e Komunës së Jegunovcit në cilësinë e kontrollorit, duke përcaktuar masat teknike dhe organizative për të siguruar fshehtësinë dhe ruajtjen e të dhënave personale të përpunuara nëpërmjet video mbikëqyrjes ,afatin dhe mënyrën e rruajtjes së videove të të dhënave personale mënyrën e fshirjes së video-incizimeve, si dhe të drejtat dhe detyrimet e personave të autorizuar që kanë qasje në sistemin e video mbikëqyrjes.

Neni 2

Qëllimi i video mbikëqyrjes në territorin e Komunës është sigurimi i mbrojtjes nga krijimi i deponive dhe mbrojtja e mjedisit në përputhje me analizën e përgatitur të qëllimit, gjegjësisht qëllimeve për të cilat është vendosur video mbikëqyrja e sipërfaqeve publike në territorin e Komunës, përkatësisht:

- Mbrojtja nga krijimi i deponive ilegale dhe ndotja e mjedisit jetësor.

Neni 3

Regjistrimet janë në një monitor të vendosur në një dhomë të Komunës, ku do të caktohet një person përgjegjës (oficer) për mbrojtjen e të dhënave personale. Oficeri është person i autorizuar për koordinimin dhe kontrollin e masave teknike dhe organizative të aplikuara për fshehtësinë dhe mbrojtjen e përpunimit të të dhënave personale, i cili ka kontroll të plotë të sistemit.

Personat e autorizuar duhet të nënshkruajnë një Deklaratë për fshehtësinë dhe mbrojtjen e përpunimit të të dhënave personale përmes sistemit të video mbikëqyrjes.

Personat e autorizuar do të kenë të drejtë të mbajnë një telefon celular pa kamerë, kurse do të jetë e ndaluar mbajtja e një telefoni celular të mençur . Të punësuarve u ndalohet të punojnë dhe të përdorin me të dhënat dhe nuk kanë të drejtë të kthejnë materiale të regjistruara ose të bartin regjistrime në media të tjera.

Neni 4

Sistemi do të implementohet në një zgjidhje të bazuar në IP, pra secila kamera, në varësi të vendndodhjes, do të lidhet me një lidhje wireless/optike direkt në ambientet e komunës.

Neni 5

Kategoritë e mëposhtme të të dhënave do të përpunohen përmes sistemit të mbikëqyrjes video në territorin e Komunës:

- Pamja fizike dhe fiziologjike e personave të cilët herë pas here vihen në fokus të kamerave të instaluara për qëllimet e përcaktuara në nenin 2 të këtij vendimi;
- Masat teknike dhe organizative për të siguruar fshehtësi dhe mbrojtjen e të dhënave personale të përpunuara përmes video mbikëqyrjes;
- Komuna do të sigurojë masat teknike të mëposhtme për fshehtësinë dhe mbrojtjen e të dhënave personale të marra përmes sistemit të video mbikëqyrjes në territorin e Komunës;
    - emrin e përdoruesit dhe fjalëkalimin e vet për të punësuarin (i autorizuar)
    - ndryshimi fjalëkalimit çdo tre muaj

Neni 6

Komuna do të sigurojë masat e mëposhtme organizative për fshehtësinë dhe mbrojtjen e të dhënave personale nëpërmjet sistemit të video mbikëqyrjes në territorin e Komunës:

- Sistemi i qasjes së automatizuar vetëm për personat e autorizuar;
- Një sistem për logimin e të gjithë atyre që ndotin mjedisin;
- Respektimin e udhëzimeve teknike për përdorimin, instalimin dhe mirëmbajtjen e pajisjeve të video mbikëqyrjes .

Neni 7

Komuna do të ruajë qasjen dhe njohuritë në të dhënat e përpunuara përmes sistemit të video mbikëqyrjes, me çka evidenca do të përmbajë të dhënat e mëposhtme:

- Numri rendor;
- Emri dhe mbiemri i personit të autorizuar;
- Koha e qasjes në sistemin e video mbikëqyrjes;
- Qëllimi i qasjes në sistemin e video mbikëqyrjes;
- Data dhe ora e kopjes së bërë deri ku bëhet qasja;

Neni 8

Në të gjitha lokacionet ku është instaluar video mbikëqyrja, në një vend të dukshëm vendoset njoftim ku thuhet se bëhet video mbikëqyrje nga Komuna dhe qëllimet për kryerjen e video mbikëqyrjes.

Neni 9

Shqyrtimi i materialit të incizuar bëhet në bazë të një kërkese me shkrim të dorëzuar në Arkivin e Komunës, duke treguar arsyet dhe bazën ligjore për të kërkuar qasje në materialin e regjistruar dhe lëshimin e miratimit me shkrim.

Materiali video shqyrtohet në hapësirë në prani të personit të autorizuar nga neni 3 i këtij vendimi.

Regjistrimet e bëra gjatë video mbikëqyrjes rruhen derisa të përmbushen qëllimet për të cilat kryhet video mbikëqyrja, por jo më gjatë se 30 ditë, përveç rasteve kur me ligj tjetër parashikon një periudhë tjetër.

Neni 10

Administratori i sistemit të video mbikëqyrjes në Komunë dhe personat e autorizuar të përcaktuar në nenin 3 të këtij vendimi kanë qasje dhe njohuri në të dhënat personale.

Personi i autorizuar i sistemit të video mbikqyrjes është personi i punësuar në Komunë siç është përcaktuar në nenin 3 të këtij vendimi.

Personi i autorizuar në sistemin e video-mbikëqyrjes është personi i punësuar nga Komuna i autorizuar me akt të veçantë (autorizim) për video mbikëqyrje, dhe nëse është e nevojshme, mund të autorizojë persona të tjerë që të kenë qasje në materialet e video-mbikëqyrjes dhe të hyjnë në njësinë kompjuterike të video mbikëqyrjes

Personi i autorizuar ka qasje në video-mbikëqyrjen, mirëmban sistemin e video-mbikëqyrjes dhe ka qasje në arkivin e materialeve të regjistruara të video-mbikëqyrjes.

Neni 11

Një vlerësim periodik kryhet nga oficeri i mbrojtjes së të dhënave personale çdo dy vjet në lidhje me rezultatet e arritura nga sistemi i video mbikëqyrjes.

Vlerësimi periodik i referohet:

- Vlerësimi i mëtejshëm i përdorimit të sistemit të video mbikëqyrjes;
- Qëllimi ose objektivat për përfundimin e video mbikëqyrjes;
- Treguesit statistikorë për qasjen në pamjet e video mbikëqyrjes;
- Mënyra e përdorimit të regjistrimeve dhe për çfarë qëllimi.

Oficeri përgatit një raport për vlerësimin e përfunduar.

Neni 12

Dispozitat e Ligjit për mbrojtjen e të dhënave personale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut, nr. 42/20 dhe 294/21) vlejnë për gjithçka që parashihet në këtë vendim.

Neni 13

Vendimi hyn në fuqi ditën e miratimit dhe do të publikohet në "Gazetën Zyrtare të Komunës së Jegunovcit".

Nr.08-527/17
10.03.2025
Jegunovce

KËSHILLI I KOMUNËS SË JEGUNOVCIT
Kryetar
Perica Saveski

Në bazë të nenit 50 paragrafi 1 pika 3 lidhur me nenin 62 paragrafi 4 të Ligjit për vetëqeverisje lokale ("Gazeta zyrtare e RM-së" nr. 5/2002) dhe nenit 39 paragrafi 1 neni 54 lidhur me nenin 53 paragrafi 3 të Statutit të Komunës së Jegunovcit ("Fletorja zyrtare e Komunës së Jegunovcit" nr. 21/03), kryetari i Komunës së Jegunovcit ,mori:

A K T V E N D I M

për shpalljen e Programit vjetor për mundësi të barabarta mes grave dhe burrave në Komunën e Jegunovcit për vitin 2025

Shpallet Programi vjetor për mundësi të barabarta mes grave dhe burrave në Komunën e Jegunovcit për vitin 2025, që Këshilli i Komunës së Jegunovcit e miratoi në mbledhjen e mbajtur më 10.03.2025.

Nr. 09-580/16
11.03.2025
Jegunovc

KOMUNA E JEGUNOVCIT
Kryetari
Dimitar Kostadinoski,d.v.

Në bazë të nenit 36 paragrafi 1 pika 15 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" numër 05/02 dhe "Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" numër 202/24), neni 14 paragrafët 1 dhe 2 të Ligjit për mundësitë e barabarta mes grave dhe burrave ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" numër 6/12, 166/14 dhe 150/15 dhe ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut ''numër 53/21) Këshilli i Komunës së Jegunovcit në mbledhjen e mbajtur më 10.03.2025 miratoi:

PROGRAMI VJETOR PËR MUNDËSI TË BARABARTA MES GRAVE DHE BURRAVE NË KOMUNËN E JEGUNOVCIT PËR VITIN 2025

I. HYRJE

Në bazë të nenit 14 të Ligjit për mundësi të barabarta për gratë dhe burrat ("Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 6/12, 166/14 dhe 150/15 dhe "Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr. 53/21), Komuna e Jegunovcit ka obligim të krijojë mundësi të barabarta në sferën politike, ekonomike, sociale, arsimore,kulturore, shëndetësore, qytetare dhe në çdo sferë të jetës shoqërore.

Njësitë e vetëqeverisjes vendore janë të detyruara të inkorporojnë parimin e mundësive të barabarta për gratë dhe burrat në planet dhe buxhetet e tyre strategjike, të monitorojnë efektet dhe ndikimin e programeve të tyre tek gratë dhe burrat dhe të raportojnë në raportet e tyre vjetore dhe të marrin pjesë në përgatitjen e Strategjisë për Barazi Gjinore në pjesën që ka të bëjë me njësitë e vetëqeverisjes lokale.

Për arritjen e këtij qëllimi, komuna, në përputhje me dispozitat e nenit 14 të këtij ligji, dhe me qëllim të zbatimit përmbajtësor të qëllimeve, ndër të tjera, është e dëshirueshme që të hartohet një Program vjetor që do të përcaktojë masat për promovimin e mundësive të barabarta për gratë dhe burrat.

Programi vjetor për mundësi të barabarta i Komunës së Jegunovcit për vitin 2025 përgatitet me qëllim të realizimit të aktiviteteve të planifikuara të komunës në fushën e mundësive të barabarta për gratë dhe burrat për vitin 2025. Duke respektuar parimin e mundësive të barabarta, pushteti lokal mund të bëjë ndryshime të rëndësishme që do të çojnë në një pozitë më të mirë të grave në komunë.

II. QËLLIMET E PROGRAMIT

Objektivat kryesore të Programit për Mundësi të Barabarta për Gratë dhe Burrat e Komunës së Jegunovcit dhe puna e KEM për vitin 2025 janë:

- Forcimi i mekanizmave institucionalë për futjen e mundësive të barabarta për gratë dhe burrat në fushat prioritare nën kompetencë të Komunës (mbrojtja sociale, arsimi, sporti, kultura, etj.).
- Promovimi i barazisë gjinore si vlerë, nëpërmjet eventeve informuese,
ngjarje, fushata dhe edukim
- Përfshirja më e madhe e grave në proceset e identifikimit të prioriteteve dhe vendimmarrjes në komunë
- Përmirësimi i njohurive të grave dhe kujdesi dhe mbrojtja e vazhdueshme e shëndetit të tyre përmes ligjëratave të organizuara dhe kontrolleve të rregullta.

Detyra kryesore e Komunës dhe Komisionit është të punojnë në përmirësimin e situatës së grave dhe burrave dhe sigurimin e barazisë midis burrave dhe grave në nivel lokal përmes procesit të përgatitjes dhe miratimit të politikave, zbatimit të tyre, monitorimit dhe vlerësimit të rezultateve të arritura.

III. FORMA TË TJERA AKTIVITETET

Format tjera të aktiviteteve që do të mbështeten me mjete nga Buxheti i Komunës së Jegunovcit janë:

- sigurimin e mbështetjes eksperte, teknike dhe të tjera me personel dhe pajisje me të cilat disponon komuna.
- Organizimi i takimeve për vendosjen e bashkëpunimit ndërmjet përfaqësuesve të Komunës dhe donatorëve potencialë të projekteve në fushën e mundësive të barabarta.

Këto forma të aktiviteteve do të realizohen sipas mundësive të komunës së Jegunovcit, në bashkëpunim me institucionet e nivelit lokal.

IV. FORMAT DHE FORMATET PËR ZBATIMIN E VEPRIMTARIVE

- Punëtori
- Lobimi dhe presionet krijuese
- Organizimi i seminareve
- Informimi i qytetarëve

- Afirmim mediatik

V. FINANCIMI

Për realizimin e aktiviteteve të lartpërmendura do të sigurohen mjete nga Buxheti i Komunës së Jegunovcit në shumë prej 60.000 denarë.

VI. DISPOZITAT PËRFUNDIMTARE

Programi është propozuar nga Komisioni për Mundësi të Barabarta mes Grave dhe Burrave.

Realizimi dhe monitorimi i aktiviteteve do të bëhet përmes Koordinatorit për Mundësi të Barabarta nga Komuna e Jegunovcit si dhe Komisionit për Mundësi të Barabarta të Grave dhe Burrave.

Ky program hyn në fuqi një ditë pas publikimit në Fletoren Zyrtare të Komunës së Jegunovcit dhe do të zbatohet deri në fund të vitit.

Nr.08-527/18
10.03.2025
Jegunovc

KËSHILLI I KOMUNËS SË JEGUNOVCIT
Kryetar
Perica Saveski

Në bazë të nenit 50 paragrafi 1 pika 3 lidhur me nenin 62 paragrafi 4 të Ligjit për vetëqeverisje lokale ("Gazeta zyrtare e RM-së" nr. 5/2002) dhe nenit 39 paragrafi 1 neni 54 lidhur me nenin 53 paragrafi 3 të Statutit të Komunës së Jegunovcit ("Fletorja zyrtare e Komunës së Jegunovcit" nr. 21/03), kryetari i Komunës së Jegunovcit ,mori:

A K T V E N D I M

për shpalljen e Vendimit për ndarjen e ndihmës financiare

Shpallet Vendimi për ndarjen e ndihmës financiare , që Këshilli i Komunës së Jegunovcit e miratoi në mbledhjen e mbajtur më 10.03.2025.

Nr. 09-580/17
11.03.2025
Jegunovc

KOMUNA E JEGUNOVCIT
Kryetari
Dimitar Kostadinoski,d.v.

Në bazë të nenit 36 paragrafi 1 pika 15 të Ligjit për vetëqeverisje lokale ("Gazeta zyrtare e RM-së" nr. 5/02 dhe"Gazeta zyrtare e RMV-së" nr. 202/24) dhe të nenit 21 paragrafi 1 pika 43 të Statutit të Komunës së Jegunovcit ("Fletorja zyrtare e Komunës së Jegunovcit" nr. 21/03), Këshilli i Komunës së Jegunovcit në mbledhjen e pesëdhjetedy të mbajtur më 10.03.2025 e shqyrtoi kërkesën e Mihaela Mishovska nga f. Bellovishtë dhe mori,

V E N D I M
për ndarjen e ndihmës financiare

Neni 1

Nga Buxheti i Komunës së Jegunovcit për Mihaela Mishovska nga f. Bellovishtë i ndahet ndihmë e njëhershme financiare në shumë prej 25.000 den.

Mjetet nga paragrafi 1 i këtij neni ndahen si ndihmë financiare për seminaret në vijim të cilët do të mbahen në Republikën e Japonisë për përgatitje për garat botërore në karate të cilat do të mbahen në Kajro Egjipt në vitin 2025.

Neni 2

Ky Vendim hyn në fuqi në ditën e shpalljes në "Fletoren zyrtare të Komunës së Jegunovcit".

Nr. 08-527/19
10.03.2025
Jegunovc

KËSHILLI I KOMUNËS SË JEGUNOVCIT
Kryetari
Perica Saveski,d. v .

Në bazë të nenit 50 paragrafi 1 pika 3 lidhur me nenin 62 paragrafi 4 të Ligjit për vetëqeverisje lokale ("Gazeta zyrtare e RM-së" nr. 5/2002) dhe nenit 39 paragrafi 1 neni 54 lidhur me nenin 53 paragrafi 3 të Statutit të Komunës së Jegunovcit ("Fletorja zyrtare e Komunës së Jegunovcit" nr. 21/03), kryetari i Komunës së Jegunovcit ,mori:

A K T V E N D I M

për shpalljen e Konkluzionit nr. 08-527/20 të datës 10.03.2025

Shpallet Konkluzioni nr. 08-527/20 të datës 10.03.2025, që Këshilli i Komunës së Jegunovcit e miratoi në mbledhjen e mbajtur më 10.03.2025.

Nr. 09-580/18
11.03.2025
Jegunovc

KOMUNA E JEGUNOVCIT
Kryetari
Dimitar Kostadinoski,d.v.

Në bazë të nenit 36 paragrafi 1 pika 15 të Ligjit për vetëqeverisje lokale ("Gazeta Zyrtare e RM-së",nr. 5/02 dhe "Gazeta Zyrtare e RMV-së",nr. 202/24) dhe nenit 21 paragrafi 1 pika 43 të Statutit të Komunës së Jegunovcit ("Fletorja Zyrtare e Komunës së Jegunovcit"nr. 21/03), për kërkesën nr. 0302-272/1 të datës 06.02.2025 të dorëzuar nga Organizata lokale Jegunovc, Këshilli i Komunës së Jegunovcit në mbledhjen e pesëdhjetedy të mbajtur më 10.03.2025 miratoi:

KONKLUZION

1. Këshilli i Komunës së Jegunovcit kërkesën nr. 0302-272/1 të datës 06.02.2025 të dorëzuar nga Organizata lokale Jegunovc të përkrahur edhe nga Organizatat lokale të fshatrave: Podbreg, Jançishtë, Raotincë, Kopanicë, Tudencë, Siriçinë, Prelubishtë, Zhillcë, Ratajë dhe Shemshovë, e përkrah kërkesën dhe kyçet në inicijativën me qëllim që të parandalohet hapja e kazinos në f. Jegunovc.

2. Ky Konkluzion hyn në fuqi në ditën e shpalljes në "Fletoren zyrtare të Komunës së Jegunovcit".

Nr. 08-527/20
10.03.2025
Jegunovc

KËSHILLI I KOMUNËS SË JEGUNOVCIT
Kryetari
Perica Saveski,d.v.

Në bazë të nenit 24-a paragrafi 3 të ligjit për ndërmarrjet publike ("Gazeta zyrtare e RM-së",nr .38/96, 6/02, 40/03, 49/06, 22/07, 83/09, 97/10, 6/12, 119/13, 41/14, 138/14, 25/15, 61/15, 39/15, 64/18, 35/19 dhe "Gazeta zyrtare e RMV-së",nr. 275/19 dhe 89/22) dhe neni 50 paragrafi 1 pika 16 të Ligjit për vetëqeverisje lokale ("Gazeta zyrtare e RM-së",nr .05/02 dhe "Gazeta zyrtare e RMV-së",nr .202/24) dhe të nenit 16 paragrafi 1 pika 1 të Statutit të Ndërmarrjes publike komunale për kryerjen e punëve botore JEGUNOVCI f.Jegunovc,Jegunovc nr. 01-2/4 të datës 02.07.2021 kryetari i Komunës së Jegunovcit më datë 03.03.2025 mori:

A K T V E N D I M

për shkarkim të Ushtruesit të detyrës Drejtor i Ndërmarrjes publike komunale për kryerjen e punëve botore JEGUNOVCI f.Jegunovc,Jegunovc

1. Lupço Stoleski nga f. Zhillçë me NVAQ 2707963470006 dhe numër të letërnjoftimit M1144417 të lëshuar nga MPB Tetovë shkarkohet nga Ushtrues detyre Drejtor i Ndërmarrjes publike komunale për kryerjen e punëve botore JEGUNOVCI f.Jegunovc,Jegunovc , përfundimisht me 02.03.2025 për arsye të përfundimit të mandatit.

2. Personi nga pika 1 e këtij Aktvendimi nr. 09-1653/1 të datës 03.09.2024 ishte emëruar Ushtrues detyre Drejtor i Ndërmarrjes publike komunale për kryerjen e punëve botore JEGUNOVCI f.Jegunovc,Jegunovc për periudhë gjashtë mujore.

3. Me hyrjen në fuqi të këtij Aktvendimi përfundon të vlejë Aktvendimi nr. 09-1653/1 të datës 03.09.2024

4. Ky Aktvendim hyn në fuqi në ditën e marrjes, dhe do të shpallet në "Fletoren zyrtare të Komunës së Jegunovcit".

Komuna e Jegunovcit
Kryetari
Dimitar Kostadinoski,d.v

Në bazë të nenit 24-a paragrafi 3 të ligjit për ndërmarrjet publike ("Gazeta zyrtare e RM-së",nr .38/96, 6/02, 40/03, 49/06, 22/07, 83/09, 97/10, 6/12, 119/13, 41/14, 138/14, 25/15, 61/15, 39/15, 64/18, 35/19 dhe "Gazeta zyrtare e RMV-së",nr. 275/19) dhe neni 50 paragrafi 1 pika 16 të Ligjit për vetëqeverisje lokale ("Gazeta zyrtare e RM-së",nr .05/02 dhe "Gazeta zyrtare e RM-së",nr. 202/24) dhe të nenit 16 paragrafi 1 pika 3 të Statutit të Ndërmarrjes publike komunale për kryerjen e punëve botore JEGUNOVCI f.Jegunovc,Jegunovc nr. 01-2/4 të datës 02.07.2021 kryetari i Komunës së Jegunovcit më datë 03.03.2025 mori:

A K T V E N D I M

për emërimin e Ushtruesit të detyrës Drejtor i Ndërmarrjes publike komunale për kryerjen e punëve botore JEGUNOVCI f.Jegunovc,Jegunovc

1. Aco Evkovski nga f. Raotincë me NVAQ 3001986470023 dhe numër të letërnjoftimit M078630 të lëshuar nga MPB Tetovë, emërohet Ushtrues detyre Drejtor i Ndërmarrjes publike komunale për kryerjen e punëve botore JEGUNOVCI f.Jegunovc,Jegunovc për periudhë nga 03.03.2025 deri 02.09.2025.

2. Ushtruesi i detyrës Drejtor i Ndërmarrjes publike komunale për kryerjen e punëve botore JEGUNOVCI f.Jegunovc,Jegunovc do ti kryej punët deri në emërimin e drejtorit të ri por jo më gjatë se gjashtë muaj nga dita e emërimit.

3. Ky Aktvendim hyn në fuqi në ditën e marrjes dhe do të shpallet në "Fletoren zyrtare të Komunës së Jegunovcit".

Komuna e Jegunovcit
Kryetari
Dimitar Kostadinoski,d.v

KONTRATË
PËR BASHKËPUNIM NDËRKOMUNAL

Lidhur ndërmjet:

1. Komunës së Jegunovcit, me seli në rr.101 nr. pn, Jegunovc, e përfaqësuar nga kryetari i komunës Dimitar Kostadinoski, nga njëra anë dhe
2. Komuna e Bërvenicës me seli në rr.„M.Tito nr. pn, Bërvenicë, e përfaqësuar kryetari i Komunës Jovica Ilievski, nga ana tjetër

Neni 1

Lëndë e kësaj Kontrate është vendosja e bashkëpunimit ndërkomunal ndërmjet dy komunave kontraktuese, në pajtim me nenin 14 të Ligjit për vetëqeverisje lokale („Gaz. zyrtare e RM-së nr. 05/02) nenit 9 paragrafi 2 dhe neni 2 të Ligjit për bashkëpunim ndërkomunal ("Gazeta Zyrtare e RM-së",nr. 79/09) për realizim me sukses të punëve dhe detyrave të punës të cilat janë në kompetencë të komunave në lëmin e mbrojtje të ambientit jetësor, (miratimin e elaborateve për mbrojtje të mjedisit jetësor dhe B –jele te integruar ekologjike), inspekcion për mbrojtje të ambientit jetësor dhe inspekcion për ndërtime, nga ana e Komunës së Bërvenicës për llogari të Komunës së Jegunovcit.

Neni 2

Komuna e Bërvenicës për Komunën e Jegunovcit nëpërmjet shërbimeve të inspeksionit t saj do të bëj mbikëqyrje inspektuese nga lëmi i mbrojtjes së ambientit jetësor dhe për ndërtime, sidhe lëmin e mbrojtje të ambientit jetësor, (miratimin e elaborateve për mbrojtje të mjedisit jetësor dhe B –jele te integruar ekologjike) etj.

Nëpunësit shtetëror nga Komuna e Bërvenicës, punët e tyre do ti kryejnë në pajtim me ligjin dhe aktet nënligjore, në pajtim me dispozitat e përcaktuara dhe standardet për këtë lloj pune.

Komuna e Bërvenicës do ti kryej punët nga neni 1 i kësaj Kontrate pa kompensim.

Neni 3

Kjo Kontratë hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga të dyja palët kontraktuese, dhe do të lidhet për kohëzgjatje më së voni deri 31.12.2025.

Neni 4

Kjo kontratë mund të prishet për arsye të mos respektimit të dispozitave nga ana e të dy palëve kontraktuese.

Kjo kontratë mund të prishet edhe me kërkesë të njërës palë kontraktuese, por pas lajmërimit paraprak nga ana e palës e cila e kërkon atë edhe atë më së paku në afat prej 30 ditëve para prishjes së kontratës.

Neni 5

Palët kontraktuese janë pajtuar kontestet eventuale ti zgjedhin me marrëveshje, në të kundërtën kompetent do të jetë Gjykata themelore e Tetovës.

Neni 6

Kjo Kontratë është lidhur në 6(gjashtë) ekzemplar të njëjt, nga tre për secilën nga palët kontraktuese dhe e njeta do të shpallet në „Gazetën zyrtare të Republikës së Maqedonisë së Veriut„ në shpenzim të Komunës së Jegunovcit.

Komuna e Jegunovcit
Kryetar
Dimitar Kostadinoski, d.v.

Nr. 03-238/1
03.02.2025

Komuna e Bërvenicës
Kryetar
Jovica Ilievski, d.v.

Nr. 03-147/1
03.02.2025

P ë r m b a j t j a

Aktvendimi për shpalljen e Kalendarit buxhetor për miratimin e Buxhetit të Komunës së Jegunovcit për vitin 2026.....1
Kalendari buxhetor për miratimin e Buxhetit të Komunës së Jegunovcit për vitin 2026.....2

Aktvendimi për shpalljen e Llogarisë përfundimtare e Buxhetit të NJVL-së së Jegunovcit për vitin 2024.....4
Llogaria përfundimtare e Buxhetit të NJVL-së së Jegunovcit për vitin 2024.....5

Aktvendimi për shpalljen e Vendimit për miratimin e Llogarisë përfundimtare e Buxhetit të NJVL-së së Jegunovcit për vitin 2024.....32
Vendimi për miratimin e Llogarisë përfundimtare e Buxhetit të NJVL-së së Jegunovcit për vitin 2024.....33

Aktvendimi për shpalljen e Konkluzionit për miratimin e Raportit të kryer të mjeteve,inventarit të imët dhe regjistrimit të arkës me gjendje më 31.12.2024 në Komunën e Jegunovcit 34
Konkluzioni për miratimin e Raportit të kryer të mjeteve,inventarit të imët dhe regjistrimit të arkës me gjendje më 31.12.2024 në Komunën e Jegunovcit.....35

Aktvendimi për shpalljen e Vendimit për dhënien e pëlqimit Llogarisë përfundimtare të vitit 2024 të Institucionit publik komunal për fëmijë-Kopshti i fëmijëve „MOLLËZAT'' f. Jegunovc Komuna e Jegunovcit.....36
Vendimi për dhënien e pëlqimit Llogarisë përfundimtare të vitit 2024 të Institucionit publik komunal për fëmijë-Kopshti i fëmijëve „MOLLËZAT'' f. Jegunovc Komuna e Jegunovcit.....37

Aktvendimi për shpalljen e Vendimit për dhënien e pëlqimit Llogarisë vjetore për vitin 2024 të SHFK„Aleksandar Zdravkovski'' Jegunovc.....38
Vendimi për dhënien e pëlqimit Llogarisë vjetore për vitin 2024 të SHFK„Aleksandar Zdravkovski'' Jegunovc.....39

Aktvendimi për shpalljen e Vendimit për dhënien e pëlqimit Llogarisë vjetore për vitin 2024 të SHFK„Shemshova'' Shemshovë.....40
Vendimi për dhënien e pëlqimit Llogarisë vjetore për vitin 2024 të SHFK„Shemshova'' Shemshovë.....41

Aktvendimi për shpalljen e Vendimit për dhënien e pëlqimit Llogarisë vjetore për vitin 2024 të SHFK„Simçe Nastovski'' Vratnicë.....42
Vendimi për dhënien e pëlqimit Llogarisë vjetore për vitin 2024 të SHFK„Simçe Nastovski'' Vratnicë.....43

Aktvendimi për shpalljen e Vendimit për dhënien e pëlqimit Llogarisë përfundimtare të vitit 2024 të IPL-Biblioteka "Светлина-Drita" f. Prelubishtë-Komuna e Jegunovcit.....44
Vendimi për dhënien e pëlqimit Llogarisë përfundimtare të vitit 2024 të IPL-Biblioteka "Светлина-Drita" f. Prelubishtë-Komuna e Jegunovcit.....45

Aktvendimi për shpalljen e Vendimit për dhënien e pëlqimit Llogarisë vjetore të vitit 2024 të Ndërmarrjes publike komunale për kryerjen e punëve botore JEGUNOVCI f.Jegunovc,Jegunovc.....46
Vendimi për dhënien e pëlqimit Llogarisë vjetore të vitit 2024 të Ndërmarrjes publike komunale për kryerjen e punëve botore JEGUNOVCI f.Jegunovc,Jegunovc.....47

Aktvendimi për shpalljen e Konkluzionit për miratimin e Raportit për realizimin e Programit për ndërtimin,rindërtimin dhe mirëmbajtjen e rrjetit të udhëve lokale dhe rrugëve të Komunës së Jegunovcit për vitin 2024.....48
Konkluzioni për miratimin e Raportit për realizimin e Programit për ndërtimin,rindërtimin dhe mirëmbajtjen e rrjetit të udhëve lokale dhe rrugëve të Komunës së Jegunovcit për vitin 2024.....49

Aktvendimi për shpalljen e Programit për ndërtimin,rindërtimin dhe mirëmbajtjen e rrjetit të udhëve lokale dhe rrugëve të Komunës së Jegunovcit për vitin 2025.....50
Programit për ndërtimin,rindërtimin dhe mirëmbajtjen e rrjetit të udhëve lokale dhe rrugëve të Komunës së Jegunovcit për vitin 2025.....51

Aktvendimi për shpalljen e Vendimit për zgjedhje të anëtarit të Këshillit drejtues të NPP „Rusino – Pollog“.....53
Vendim për zgjedhje të anëtarit të Këshillit drejtues të NPP „Rusino – Pollog“.....54

Aktvendimi për shpalljen e Vendimit për miratimin e Planit për menaxhim me rrezikun nga vërshimet në territorin e Komunës së Jegunovcit.....55
Vendim për miratimin e Planit për menaxhim me rrezikun nga vërshimet në territorin e Komunës së Jegunovcit.....56

Aktvendimi për shpalljen e Vendimit për mënyrën e kryerjes së video mbikëqyrjes së hapësirave publike në territorin e Komunës së Jegunovcit.....57
Vendim për mënyrën e kryerjes së video mbikëqyrjes së hapësirave publike në territorin e Komunës së Jegunovcit.....58

Aktvendimi për shpalljen e Programit vjetor për mundësi të barabarta mes grave dhe burrave në Komunën e Jegunovcit për vitin 2025.....61
Programi vjetor për mundësi të barabarta mes grave dhe burrave në Komunën e Jegunovcit për vitin 2025.....62

Aktvendimi për shpalljen e Vendimi për ndarjen e ndihmës financiare.....65
Vendimi për ndarjen e ndihmës financiare.....66

Aktvendimi për shpalljen e Konkluzionit nr. 08-527/20 të datës 10.03.2025.....67
Konkluzioni nr. 08-527/20 të datës 10.03.2025.....68

Aktvendimi për shkarkim të Ushtruesit të detyrës Drejtor i Ndërmarrjes publike komunale për kryerjen e punëve botore JEGUNOVCI f.Jegunovc,Jegunovc 69
Aktvendimi për emërimin e Ushtruesit të detyrës Drejtor i Ndërmarrjes publike komunale për kryerjen e punëve botore JEGUNOVCI f.Jegunovc,Jegunovc.....70
Kontratë për bashkëpunim ndërkomunal.....71